

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Programi mësimor

ARSIMI FIGURATIV

për klasën I

Shkup, viti 2021

TË DHËNAT THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	<i>Arsimi figurativ</i>
Lloji/ kategoria e lëndës mësimore	E detyrueshme
Klasa	I (e parë)
Temat/fushat në programin mësimor	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Vizatim</i> • <i>Pikturim</i> • <i>Vulosje</i> • <i>Formësim plastik</i>
Numri i orëve	1 orë në javë /36 orë në vjet
Pajisjet dhe mjetet	<ul style="list-style-type: none"> • Mjetet audiovizuale: televizor, DVD player, projektor LCD, kasetofon, aparat fotografues digjital, kompjuter, tabletë e mençur (smart tabletë), tabletë vizatimi, printer ose pajisje tjetër digjitale. • Internet, softuerë mësimor. • Mjete dhe materiale vizatimi (letër, laps, shkumësa prej druri, shkumësa me vaj, shkumësa, fllomasterë, materiale natyrore, këmbaleca ...) • Mjete vizuale (vizatime, fotografi, punime, revista, posterë, aplikacione, ilustrime, broshura, vizita në muze dhe ekspozita arti etj.) • Mjete dhe materiale pikturimi (shkumësa me ujë, bllok, furça, letër - hamer, ngjyra tempera, kolazh, paletë, letër me ngjyra, ngjitës, materiale natyrore dhe artificiale). • Mjete dhe materiale për vulosje (vulë, shabllone dhe materiale për krijimin e shablloneve, karton, ngjyra ekologjike etj.) • Mjete për formimin e plastikës (plastelinë, brumë, argjilë, rërë, dëborë, polisterol, plastikë etj.) • Materiale krijuese jo vizatimore (krehër, furça dhëmbësh, make - up, manikyryn e thonjve, qiri, sapun, ombrellë, kapelë, gur, gazë, CD, shtrydhëse frutash, perime dhe fruta, tekstile etj.)
Normativa e kuadrit mësimor	Punën edukative – mësimore në klasën e parë mund ta realizojë personi i cili është i kualifikuar:

- Profesor i mësimi klasor, VII/1 ose VI/1 (sipas KMK) dhe 240 SETK;
- Profesor i edukimit parashkollor, VII/1 ose VI/1 (sipas KMK) dhe 240 SETK;
- Pedagog i diplomuar, VII/1 ose VI/1 (sipas KMK) dhe 240 SETK.

LIDHJA ME STANDARDET KOMBËTARE

Rezultatet e të mësuarit të theksuara në programin mësimor çojnë në marrjen e kompetencave të mëposhtme të përfshira me lëminë e **Shprehjes dhe kulturës artistike** të Standardeve Kombëtare: -----

<i>Nxënësi/nxënësja din dhe/ose mund:</i>	
VIII-A.1	të manifestojë njohuri të formave të ndryshme të shprehjes artistike nga të gjitha fushat e kulturës (letërsi, muzikë, arte vizuale, arte skenike, arte dekorative, arkitekturë, dizajn);
VIII-A.3	të shprehë idetë, përvojat dhe emocionet e veta, duke përdorur forma artistike ose forma të tjera të shprehjes krijuese (individuale ose kolektive);
VIII-A.5	të manifestojë njohuri për kulturën e vet dhe mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj përmes letërsisë dhe arteve vizuale, muzikës dhe vallëzimit, ndërtesave dhe produkteve të tjera kulturore.
<i>Nxënësi/nxënësja pranon se:</i>	
VIII-B.2	qëndrimi kritik ndaj produkteve të ndryshme të artit është i rëndësishëm për zhvillimin e vlerave estetike individuale dhe shoqërore.

Programi mësimor gjithashtu përfshin kompetencat përkatëse në fushat e mëposhtme të standardeve kombëtare:

Shkrim - leximin digjital, Zhvillimin personal dhe social, Shoqërinë dhe kulturën demokratike dhe Teknikën, teknologjinë dhe sipërmarrësinë.

<i>Nxënësi/nxënësja din dhe ka mundësi:</i>	
IV-A.2	të vlerësojë se kur dhe në çfarë mënyrë nevojitet përdorimi efektiv i TIK që të zgjidhet një detyrë/problem;

IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacioni i nevojitet atij/asaj, të gjejë, të zgjedhë dhe të shkarkojë të dhëna digjitale, informacione dhe përmbajtje;
V-A.4	të vlerësojë aftësitë dhe arritjet e tij/saj (përfshirë anët e forta dhe të dobëta) dhe mbi atë bazë të përcaktojë përparësitë që do t'i mundësojnë atij/asaj të zhvillohet dhe të përparojë;
V-A.6	të vendosë qëllime për të mësuar dhe për vetë-zhvillim dhe për të punuar në tejkalimin e sfidave që dalin në rrugën drejt arritjes së tyre;
V-A.7	të përdorë përvojat e veta për të lehtësuar mësimin e tyre dhe për të rregulluar sjelljen e tyre në të ardhmen;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë të përshtatshme, duke treguar ndjeshmëri dhe mirëkuptim për të tjerët dhe duke shprehur shqetësimet dhe nevojat e veta në një mënyrë konstruktive;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e tyre me të tjerët dhe duke marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve;
V-A.17	të kërkojë reagime dhe mbështetje për veten e tyre, por gjithashtu të ofrojë reagime dhe mbështetje konstruktive për përfitimet e të tjerëve;
V-A.19	të bëjë sugjerime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe të parashikojë pasojat në mënyrë që të nxjerrë përfundime dhe të marrë vendime racionale;
VI-A.5	të kuptojë ndryshimet ndërmjet njerëzve për çfarëdo baze (gjinia dhe përkatësia etnike, mosha, aftësitë, statusi shoqëror etj.);
VI-A.6	të njohë praninë e stereotipeve dhe paragjyqimeve mes vetes dhe të tjerëve të kundërshtojë diskriminimin;
VII-A.4	të shfaqë ide dhe të shpikë aktivitete që shpiejnë në produkte dhe/ose shërbime.
<i>Nxënësi/nxënësjë kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	shkrim-leximi digjital është thelbësor për jetën e përditshme - lehtëson të mësuarit, jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, krijimtarisë dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim;
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e dikujt kryesisht varen nga puna që ai/ajo investon dhe rezultatet që ai/ajo arrin;
V-B.4	çdo veprim që ai ndërmerr ka pasoja për të dhe/ose mjedisin e tij/saj;
V-B.7	iniciativa, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, arritjen e qëllimeve dhe tejkalimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	bashkëveprimi me të tjerët është i dyanshëm - siç ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'i mundësojnë atij për të përmbushur interesat dhe nevojat e tij, ashtu ka edhe përgjegjësi që t'u japë hapësirë të tjerëve për të kënaqur interesat dhe nevojat e tyre;
V-B.9	kërkimi i informatave kthyesë dhe pranimi i kritikave konstruktive çojnë në përparim personal në një nivel individual dhe shoqëror.

REZULTATET E MËSIMIT

<p>Tema: VIZATIM Gjithsej orë: 15</p>	
<p>Rezultatet e mësimit</p> <p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. njohë, dallojë dhe përdorë mjete vizatimi; 2. vizatojë një vizatim të thjeshtë, duke përdorur elementet bazë artistikë në vizatim; 3. prezantojë veten dhe të dashurit e tij përmes vizatimit dhe vizatimit të objekteve dhe fenomeneve nga mjedisi; 4. krijojë vizatime të thjeshta në kompjuter. 	
<p>Përmbajtje (dhe nocione)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mjetet themelore dhe materialet për vizatim (letra, lapsa, lapsa prej druri, shkumësa, shkumësa me vaj, lapsa, materiale natyrore, vizatime). 	<p>Standardet e vlerësimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njeh dhe shqipton mjete dhe materiale të ndryshme për vizatim. • Emrat e bazave dhe materialeve të vizatimit. • Bën dallimin ndërmjet vizatimeve të materialeve të ndryshme.
<ul style="list-style-type: none"> • Bazat e arteve figurative në vizatim (pika, vija, ngjyra, drejtimi, madhësia, forma). 	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan vizatimet përmes gjuhës së artit. • Vizaton linja të ndryshme duke kombinuar mjete dhe materiale të ndryshme.
<ul style="list-style-type: none"> • Vizatim i thjeshtë (vizatim, vijat: e hollë, e trashë, horizontale, vertikale, e zhdrejtë, e valëzuar, e hapur, e mbyllur, e ndërprerë, e gjatë, e shkurtër, e drejtë, e lakuar, zigzage etj.). 	<ul style="list-style-type: none"> • Dallon dhe krahason lloje të ndryshme të vijave. • Vizaton objekte dhe gjësende, duke përdorur linja të ndryshme. • Bën në mënyrë të pavarur vizatime të thjeshta në kompjuter (vetveten, shokun, me vija të ndryshme krijon forma, për shembull, rrethin, sheshin, trekëndëshin, vizaton emotikone, diellin, shiun ...).
<p>Shembuj të aktiviteteve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënësi tregon, përshkruan mjetet themelore për vizatim, shpjegon tiparet dhe vetitë e tyre dhe demonstroi se çfarë dhe si mund të vizatohet me to. • Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla, marrin mjete dhe materiale të ndryshme për vizatim dhe i klasifikojnë ato sipas llojit. • Nxënësit, duke përdorur mjete dhe materiale të ndryshme të vizatimit, vizatojnë veten e tyre, të dashurit - miqtë, anëtarët e familjes, objektet dhe fenomenet nga mjedisi, shtëpinë dhe shkollën, personazhet e preferuar nga tregimet dhe poezitë. • Nxënësit, në grupe të vogla, vizatojnë vija të ndryshme në letër (horizontale, vertikale, të valëzuara, të drejta, të lakuara, zigzage etj.) dhe më pas, brenda grupit, lëvizin në hapësirë sipas vijave të vizatuara. 	

- Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla, bien dakord të krijojnë një vizatim të përbashkët në të cilin ata do të paraqesin objekte, fenomene dhe / ose objekte nga mjedisi i afërt, dhe më pas do ta vizatojnë atë, ku çdonjëri nga grupi kontribuon duke vizatuar një element të veçantë të vizatimit.
- Nxënësit vizatojnë me material natyral në sipërfaqe të ndryshme sipas udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi, për shembull, me pirunë plastike vizatojnë vija të gjata, të shkurtra, të drejta, të lakuara, të holla, të trasha.
- Nxënësit krijojnë vepra arti me mjete të ndryshme vizatimi: qymyr druri, laps, grafit, shkumës, pastel ...
- Nxënësit vërejnë ngjashmëri midis pëllëmbës dhe një gjethe panje me ndihmën e një thjerrëze dhe i paraqesin ato artistikisht me një vizatim.
- Nxënësit aftësohen të krijojnë një vizatim të thjeshtë në kompjuter me ndihmën e mësimdhënësit.

Tema: **PIKTURË**

Gjithsej orë: **9**

Rezultatet e mësimi

Nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje të:

1. përdorë materiale dhe mjete të ndryshme për pikturë;
2. dallojë ngjyrat themelore dhe të shprehet në mënyrë krijuese me to;
3. krijojë fotografi dhe kolazhe të thjeshta në kompjuter, duke përdorur ngjyrat themelore.

Përmbajtjet (dhe nocionet)

Standardet e vlerësimit

- Mjetet dhe materialet themelore të pikturës (ngjyra me ujë, bllok, furça, letër hamer, tempera, kolazh, paletë, letër me ngjyra, ngjitës, materiale natyrore, materiale artificiale ...).

- Dallon dhe shqipton baza të ndryshme, mjete dhe materiale për pikturim.
- Zbaton baza dhe materiale të ndryshme në pikturim.
- Bën dallim ndërmjet pikturës dhe kolazhit.

- Bazat e arteve figurative në pikturë (ngjyra, madhësia, forma, hapësira).

- Njeh dhe përshkruan një imazh duke përdorur gjuhën e artit.
- Bën dallimin midis koncepteve të pikturës dhe elementeve artistike.

- Piktura dhe kolazhi (pikturë, kolazh, ngjyra themelore, hije, dritë, errësirë, pikturë ...).

- Njeh dhe tregon ngjyrat themelore dhe nuancat e tyre.
- Përdor ngjyrat themelore dhe modelimin e tyre në pikturë.
- Pikturon personazhe dhe sende të njohura nga mjedisi (për shembull, mësimdhënësin, klasën, oborrin e shkollës, personazhin e preferuar).
- Krijon një imazh me një kolazh të materialeve natyrore dhe artificiale.
- Krijon një imazh të thjeshtë kompjuteri duke përdorur ngjyrat kryesore.
- Dizajnon pikturë të zakonshme në kompjuter me përdorimin e ngjyrave themelore.

Shembuj të aktiviteteve

- Mësimdhënësi tregon, përshkruan dhe shpjegon shtresat, mjetet dhe materialet për pikturim (dhe karakteristikat dhe vetitë e tyre) dhe demonstroi se çfarë dhe si mund të pikturohet me to.
- Nxënësit, duke përdorur shtresa të ndryshme, mjete dhe materiale të ndryshme, vizatojnë personazhe, sende dhe fenomene (shkollën, mësuesin, klasën, personazhe nga tregime etj.).
- Me ndihmën e mësimdhënësit nxënësit presin pjesë nga letra me ngjyra dhe në fletë për vizatim bëjnë kolazh me ngjyra themelore (shembull: me rrahë bëjnë pikturë me ngjyrë të kuqe, me katrorë në të kaltër dhe trekëndësha në të verdhë) dhe i ekspozojnë ato në një vend të dukshëm.
 - Nxënësit, të ndarë në grupe sipas ngjyrave themelore, formojnë një mini kolazh materialesh të prera në forma të ndryshme dhe të ngjyrosura në hije të ndryshme të ngjyrës „së tyre” dhe e vendosin në një poster të përbashkët.
- Nga letrat me ngjyra dhe revistat, nxënësit presin ose grisin forma të ndryshme dhe bëjnë një kolazh të tyre individual (me zgjedhjen e tyre ose për një temë të caktuar).
 - Nxënësit bëjnë vepra nga materiale arti jo standarde (piktura me gishta).
- Mësimdhënësi siguron materiale natyrore dhe artificiale (lule, gjethe, pambuk, kokoshka, letër me ngjyra ...) nga të cilat nxënësit, të ndarë në grupe, bëjnë dru duke përdorur ngjyrën e duhur për çdo stinë të vitit dhe e shfaqin punën e tyre në një vend të dukshëm .
 - Mësimdhënësi i njëj nxënësit me ngjyrat dhe hijet themelore me një demonstrim të figurave, organizon një lojë në të cilën do të merren hijet e ngjyrave themelore: në një gotë pikon ngjyrë të kuqe dhe duke shtuar ujë bën hije më të lehta që fëmijët i vërejnë. Procedurën e përsërisin me ngjyra uji blu dhe të verdhë.
- Nxënësit në mënyrë të pavarur i përziejnë ngjyrat e ujit (të kuqen, të kaltrën dhe të verdhën) me ujë që të fitojnë nuanca më të errëta dhe më të hapura dhe i nuancojnë në letër.
- Mësimdhënësi organizon lojën dita – nata dhe i aktivizon nxënësit në ilustrimin e ditës dhe të natës (e hapur, e mbyllur).
- Mësimdhënësi jep udhëzime dhe nxënësit shprehen në mënyrë krijuese dhe krijojnë punë përmes veprimeve të ndryshme: larje, fryrje, spërkatje, gërvishtje, tundje, palosje etj.
- Nxënësit, me udhëzim të mësimdhënësit, bëjnë krijime nga kapelet e vjetra, ombrellat, tekstilet, petërat, garzat etj., duke pikturuar mbi to me ngjyra të ndryshme.
- Duke përdorur një shtrydhëse frutash, mësimdhënësi shtrydh perime dhe fruta, merr lëngje me ngjyra të ndryshme dhe nxënësit, duke përdorur këto ngjyra natyrore, shprehen artistikisht.
- Mësimdhënësi paraqet dhe krijon vizatime të ndryshme kompjuterike që nxënësit i ngjyrosin për të krijuar imazhe kompjuterike.
 - Nxënësit krijojnë një ilustrim në kompjuter duke përdorur ngjyrat themelore.

Tema: **VULOSJE**

Orët e përgjithshme: **5**

Rezultatet e mësimit

Nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje të:

1. zgjedhë dhe përdorë objekte të ndryshme të cilat mund të jenë të lyera me ngjyrë për të dhënë vulosje të ndryshme;
2. vulosë në mënyrë të pavarur dhe të marrë pjesë në zhvillimin e shablloneve të vulosjes;
3. kombinojë vulosje të njëjta dhe të ndryshme për të krijuar modele dhe kompozime.

Përmbajtjet (dhe nocionet)	Standardet e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none">• Bazat themelore dhe materialet për vulosje (vulosje, bllok, material për vulosje).	<ul style="list-style-type: none">• Bën dallimin midis substrateve dhe materialeve të ndryshme të vulosjes (të lëmuara ose të përafërta, të bardha ose të lyer, tekstile, plastike, dru dhe letër).• Përshkruan ndryshimet midis gjurmëve në baza të ndryshme
<ul style="list-style-type: none">• Bazat e artit figurativ në vulosje (vulë, shenjë, model, shabllon).	<ul style="list-style-type: none">• Përdor vula të gatshme (shabllone) për vulosjen e gjurmëve në forma dhe madhësi të ndryshme.• Bën një vulë (model) në mënyrë të pavarur dhe/ose me ndihmën e një tjetri.• Bën modele duke përsëritur të njëjtat gjurmë.• Krijon kompozime duke bashkuar shabllone.

Shembuj për aktivitete

- Mësimdhënësi tregon lloje të ndryshme të shtresave dhe materialeve të vulosjes dhe demonstroi se çfarë dhe si mund të vulojë me to dhe më pas nxënësit e përsërisin të njëjtën gjë.
- Mësimdhënësi përdor një shtresë të lëmuar dhe të vrazhdë, të bardhë dhe të tonifikuar në shtyp dhe nxënësit i krahasojnë vulosjet.
- Mësimdhënësi demonstroi ndryshimin në shtypshkrimet e marra nga goditja e vulës gjithnjë e më dobët në nënshtresë dhe më pas nxënësit praktikojnë vulosjen.
- Duke ndjekur udhëzimet e mësimdhënësit, nxënësit bëjnë vulosje nga duart dhe këmbët e tyre duke përdorur ngjyra ekologjike me mjedisin.
- Nxënësit përdorin objekte të ndryshme (lodra, forma gjeometrike etj.) për vulosje.
- Nxënësit bëjnë vulosje nga materiale të ndryshme (shembull: sfungjer, patate, gjethë, lule, fruta, lëng frutash), i lyejnë me ngjyra të ndryshme dhe në nënshtresa të ndryshme (shembull: tekstil, plastikë, dru) bëjnë vulosje dhe i krahasojnë ato.
- Nxënësit, nën udhëzimin e mësimdhënësit, bëjnë modele për shall, duke përsëritur të njëjtën vulë.
- Nxënësit, nën udhëzime të mësimdhënësve, bëjnë kompozime nga modele të ndryshme (shembull: shtëpi, tren, makinë, objekte të ndryshme etj.).
- Mësimdhënësi i fotografon punimet e secilit nxënësi, bën kompozime prej tyre dhe i shtyp në printer (mundësisht me ngjyra).

Tema: **FORMËSIMI PLASTIK**

Gjithsej orët: **7**

<p>Rezultatet e mësimit</p> <p>Nxënësi/nxënësja do të aftësohet të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. zgjedh dhe përdor mjete për modelim dhe formësim; 2. bën figura të zakonshme nga plastelina/brumi dhe letra; 3. krijon me procedura të ndryshme: këputje, prerje, lakim, bashkim, ndarje, palosje, formësim. 	
<p>Përmbajtjet (dhe nocionet)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Materialet/mjetet themelore për formësimin plastik (argjilë, plastelinë, brumë, materiale natyrore dhe artificiale). • Bazat e arteve figurative në formësimin plastik (formësimi, figura, origami, ndërtimi, materiali i ricikluar/mbeturinave). 	<p>Standardet për vlerësim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njeh dhe dallon materialet e modelimit. • Identifikon materialet natyrore dhe artificiale që mund të përdoren për formësimin. • Përdor një larmi materialesh natyrore dhe artificiale në formësim. • Bën figura kafshësh, shtëpi, karaktere nga materiale të ndryshme për formim (plastelinë dhe brumë). • Bën figura të thjeshta letre (origami). • Ndërton ndërtesa nga materiali i ricikluar / i përdorur më parë.
<p>Shembuj të aktiviteteve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit bëjnë një përzierje të materialeve të ndryshme (të butë, të fortë) dhe sipas udhëzimeve të dhëna nxënësit hulumtojnë (shtypin, tërheqin, rrokullisin). Nga brumi dhe/ose materialet tjera ato krijojnë forma të përshtatshme në madhësi të ndryshme sipas qëllimit. Për shembull, tortë dhe ëmbëlsira për ditëlindje, bizhuteri, zbukurime. <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit gërmojnë, gërvishtin, grimcojnë një qiri ose sapun dhe krijojnë punime nga materialet sipas udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi. • Nxënësit modelojnë forma të ndryshme (rërë, shtëpi, karaktere përrallash, dordolec, automjete, kafshë etj.) nga rëra, toka, uji ose bora me kovë dhe mjete plastike. • Nxënësit që modelojnë nga plastelina ose balta modelojnë në mënyrë të pavarur figura të thjeshta (pemë, perime, automjet, semafor etj.) dhe bashkërisht bëjnë një ekspozitë të punimeve në një vend të dukshëm. • Nxënësit me ndihmën e mësimdhënësit krijojnë forma të reja duke kombinuar materiale dhe sende natyrore dhe artificiale (shembuj: lodra, predha, myshk, lëvore, fara, gjethe) formojnë figura (shtëpi, kafshë etj.). • Mësimdhënësi iu tregon nxënësve se si me palosjen e letrës me ngjyrë bën origami dhe me ndihmën e saj ata bëjnë karuselë ose bëjnë lule, gota letre, insekte, kafshë etj. • Nxënësit nga shishet e përdorura plastike, gota plastike, gazeta, kartona, d.m.th. materiali i ricikluar / i përdorur më parë, të cilit mund t'i jepet përdorim i ri (ndërtojnë/formojnë ndërtesa, ura, shtëpi etj.). 	

- Nxënësit krijojnë vepra arti pasi „studiojnë” hapësirën e brendshme dhe të jashtme dhe format e enëve, tubave, kutive (brenda / jashtë, të hapura / të mbyllura, të mëdha / të vogla).

PËRFSHIRJA, BARAZIA GJINORE / NDJESHMËRIA, INTERKULTURA DHE INTEGRIMI NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi siguron përfshirjen duke inkuadruar të gjithë nxënësit në të gjitha aktivitetet gjatë orës. Mundëson që çdo fëmijë të angazhohet në mënyrë konjitive dhe emocionale nëpërmjet përdorimit të qasjeve të përshtatshme (individualizimi, diferencimi, puna në ekip, mbështetja e shokut të klasës). Kur punojnë me nxënës me aftësi të kufizuara, zbatojnë një plan arsimor individual (me rezultate të përshtatura të të nxënësve dhe standarde vlerësimi) dhe kur është e mundur, përdorin mbështetje shtesë nga njerëz të tjerë (asistentë personalë dhe arsimorë, ndërmjetësues arsimorë, tutorë vullnetarë dhe profesionistë nga shkollat e qendrër burimore). Mbikëqyrë rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet në nevojë, në mënyrë që të jenë në gjendje të identifikojnë vështirësitë e të mësuarit në kohën e duhur, për t'i inkurajuar dhe mbështetur ata në arritjen e rezultateve të të nxënësve.

Gjatë realizimit të veprimtarive, mësimdhënësi i trajton si djemtë ashtu edhe vajzat në mënyrë të barabartë, duke u kujdesur që të mos u caktojë atyre role stereotipe gjinore. Kur formon grupe pune, ai përpiqet të sigurojë ekuilibrin gjinor. Kur përzgjedhin materiale shtesë në mësimdhënie, përdorin ilustrime dhe shembuj që janë të ndjeshëm gjinor dhe etnikisht / kulturor dhe inkurajojnë barazinë gjinore, d.m.th. promovojnë ndërkulturalizmin. Gjithashtu, mësimdhënësi është i kujdesshëm që të mos përçohen stereotipet gjinore dhe etnike në punën e nxënësve.

Kur është e mundur, mësimdhënësi përdor integrimin e aktiviteteve / koncepteve të artit figurativ me përmbajtjet / standardet e lëndëve të tjera në planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies. Në këtë mënyrë, kjo lëndë motivon nxënësit për të mësuar lëndë të tjera dhe ndihmon në zotërimin e tyre më të lehtë.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'iu mundësuar nxënësve të arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimitdhënësi rregullisht i mbikëqyrë dhe i vlerëson arritjet e nxënësve gjatë mësimitdhënies. Mblidhen treguesit për aktivitetet e tyre, motivimi për krijimin e artit, angazhimi i nxënësve, angazhimi për punë, puna individuale, puna dyshe dhe në grup. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin komente të cilat tregojnë nivelin e suksesit në realizimin e aktivitetit /detyrës dhe japin udhëzime për përmirësim (vlerësim formues). Për atë qëllim, mësimitdhënësi i përcjell dhe i vlerëson:

- përgjigjet me gojë për pyetjet e bëra nga mësimitdhënësi ose shokët e klasës;
 - aktivitetin praktik gjatë orës (pjesëmarrjen në aktivitete);
 - veprat e bëra të artit (vizatim, pikturë, vulosje, formim plastik);
 - pjesëmarrjen në përpunimin e veprave të përbashkëta.

Gjatë përcjelljes së arritjeve të nxënësve, mësimitdhënësi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë qasjes individuale të arritjeve të secilit nxënës individualisht. Në fund të vitit, kryhet një vlerësim përshkrues përmbledhës i standardeve të arritura të vlerësimit.

Fillimi i zbatimit të programit mësimor	2021/2022 година
Institucioni / bartës i programit	Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Në pajtim me nenin 30, paragrafi 3 i Ligjit të Arsimit Fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19 dhe 229/20) ministrja e Arsimit dhe e Shkencës miratoi programin mësimor për lëndën <i>Arsimi figurativ</i> për klasën I .	nr. _____ viti _____ Ministrja e Arsimit dhe e Shkencës, Milla Carovska _____